



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE  
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR  
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

**Numri:** KSC-CC-2020-11

**Vendos:** **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**  
Gjykatës Vidar Stensland, Kryegjykatës  
Gjykatës Antonio Balsamo  
Gjykatës Roumen Nenkov

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Pjesëmarrës parashtrues:** Prokurori i Specializuar

**Data:** 6 tetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Kërkesë e Prokurorisë për leje për paraqitjen e parashtrimeve**

---

**Zyra e Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

1. Më 18 shtator 2020, Kryetarja e Kuvendit të Kosovës i përcolli Kryetares së Dhomave të Specializuara një amendament të propozuar të Kushtetutës<sup>1</sup> ('amendamenti i propozuar'), duke kërkuar referimin e tij në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ('DHSGJK').<sup>2</sup> Më 22 shtator 2020, Referimi iu caktua këtij paneli të DHSGJK-së ('Paneli').<sup>3</sup> Më 5 tetor 2020, paneli, ndër të tjera ia komunikoi referimin një numri të autoriteteve të interesuara dhe i autorizoi ata që të bëjnë parashtrime me shkrim në lidhje me pranueshmërinë dhe themelësinë e referimit deri më 19 tetor 2020.<sup>4</sup>
2. Në pajtim me rregullën 15(2) ose, si alternativë, rregullën 16 të Rregullores,<sup>5</sup> ZPS-ja kërkoi leje që të bëjë parashtrime<sup>6</sup> me shkrim në lidhje me pranueshmërinë dhe themelësinë e referimit, duke respektuar të gjitha kriteret që vlejné për parashtrimet e autoriteteve të tjera të interesuara.<sup>7</sup>
3. Referimi ka të bëjë me nenin 162 to Kushtetutës, që rregullon 'organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar'.<sup>8</sup> Konkretisht, amendamenti i propozuar ka të bëjë me mandatin e Dhomave të Specializuara dhe të ZPS-së<sup>9</sup> dhe rrjedhimisht, me përgjegjësinë e ZPS-së për të hetuar dhe ndjekur penalisht personat përgjegjës për krime që janë brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.<sup>10</sup> Gjatë ushtrimit të mandatit të saj, ZPS-ja

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, me ndryshimet e bëra me 3 gusht 2015 ('Kushtetuta').

<sup>2</sup> Shkresë e referimit të amendamentit të propozuar të Kushtetutës së Kosovës, 18 shtator 2020, KSC-CC-2020-11/F00001 ('Referimi'), me një Shtojcë, KSC-CC-2020-11/F00001/A01.

<sup>3</sup> Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese, 22 shtator 2020, KSC-CC-2020-11/F00002. *Shih gjithashtu* Vendim për gjuhën e punës, 24 shtator 2020, KSC-CC-2020-11/F00003.

<sup>4</sup> Vendim mbi njoftimin e referimit dhe kërkesë për informacion, 5 tetor 2020, KSC-CC-2020-11/F00003 ('Vendim mbi njoftimin').

<sup>5</sup> Rregullorja e Punës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, KSC-BD-03/Rev3/2020 ('Rregullorja').

<sup>6</sup> Rregulla 15(4) (parashih që, paneli merr vendimin mbi bazën e parashtrimeve të paraqitura me shkrim, përveçse kur në interes të administrimit të duhur të drejtësisë mbahet seancë). Nëse paneli vlerëson se nevojitet mbajta e seancës gojore, ZPS-ja kërkon që t'i mundësohet gjithashtu që të bëjë parashtrim me gojë.

<sup>7</sup> Vendim mbi njoftimin, KSC-CC-2020-11/F00003, f. 6, paragrafët 1, 3-4.

<sup>8</sup> Kushtetuta, neni 162(1).

<sup>9</sup> Shtojca e referimit, KSC-CC-2020-11/F00001/A01, faqet 5-6.

<sup>10</sup> Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'), neni 35(1).

është e obliguar që të respektojë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.<sup>11</sup> Rrjedhimisht, ZPS-ja ka interes të drejtpërdrejtë në përmbajtjen e referimit dhe ndikohet drejtpërdrejtë prej lëndës së referimit.

4. Për arsyet e dhëna më lart, parashtrimet e ZPS-së sa i përket pranueshmërisë dhe themelësisë së referimit do ta ndihmonin panelin në vendosjen e drejtë të çështjes.<sup>12</sup>

**Numri i fjalëve (në origjinal): 481**

/nënshkrim/

---

**Xhek Smith**

**Prokurori i Specializuar**

E martë, 6 tetor 2020  
Në Hagë, Holandë.

---

<sup>11</sup> Kushtetuta, neni 162(2). *Shih gjithashtu* Rregulloren e Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, rregulla 30.

<sup>12</sup> Megjithëse në rrethana të ndryshme, ZPS-ja është ftuar më parë që të bëjë parashtrime kur referimet kanë të bëjnë me veprimet e ZPS-së. *Shih, për shembull*, Njoftim në lidhje me parashtrimin e kundërpërgjigjes, publik, 18 nëntor 2019, KSC-CC-2019-07/F00006; Njoftim në lidhje me parashtrimin e kundërpërgjigjes, 18 janar 2019, KSC-CC-2019-05/F00003.